



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.187

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1081, datë 29.12.2010	Për përzgjedhjen e kompanisë austriake që do të përgatitë projektin e fisibilitetit në lidhje me projektet në fushën e teknologjisë së informacionit, që do të financohen në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë.....	10363
Udhëzim i MASH nr.35, datë 5.11.2010	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011.....	10363
Udhëzim i MASH nr.38, datë 2.12.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.35, datë 5.11.2010 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011”.....	10366
Urdhër i MASH nr.504, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master profesional” në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.....	10366
Urdhër i MASH nr.505, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master profesional” në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër.....	10367
Urdhër i MASH nr.506, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master profesional” në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.....	10368
Urdhër i MASH nr.507, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master profesional” në universitetin “Fan.S.Noli”, Korçë.....	10369
Urdhër i MASH nr.508, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master i shkencave” në universitetin “Fan.S.Noli”, Korçë.....	10369
Urdhër i MASH nr.509, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master i shkencave” në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.....	10370

Urdhër i MASH nr.510, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master i shkencave” në Universitetin e Tiranës.....	10371
Urdhër i MASH nr.511, datë 8.11.2010	Për hapjen e programit të studimit “Master i shkencave” në “Ekonomi dhe agrobiznes” në Universitetin Bujqësor të Tiranës.....	10372
Urdhër i MASH nr.512, datë 8.11.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master i shkencave” në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.....	10372
Urdhër i MASH nr.554, datë 9.12.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.....	10373
Urdhër i MASH nr.559, datë 10.12.2010	Për hapjen e programit të integruar të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës.....	10374
Urdhër i MASH nr.570, datë 15.12.2010	Për shpërndarjen e kuotave të pranimit për transferim studimesh, në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, për vitin akademik 2010-2011.....	10374
Urdhër i MASH nr.571, datë 15.12.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.....	10376
Urdhër i MASH nr.605, datë 29.12.2010	Për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës.....	10377
Urdhër i MASH nr.606, datë 29.12.2010	Për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në “Mjekësi urgjence” dhe “Neurokirurgji”, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.....	10377
Urdhër i MASH nr.607, datë 29.12.2010	Për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës.....	10378
Vendim i ERE nr.30, datë 9.4.2010	Për rishikimin e rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.....	10379
Vendim i ERRU nr.52, datë 10.12.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, për sh.a. ujësjellës Novoselë.....	10379
Vendim i ERRU nr.53, datë 10.12.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, për sh.a. ujësjellës Kurbin.....	10380
Vendim i ERRU nr.54, datë 17.12.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës Përmet.....	10380
Vendim i ERRU nr.55, datë 29.12.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës-kanalizime Berat-Kuçovë.....	10381

VENDIM
Nr.1081, datë 29.12.2010

**PËR PËRZGJEDHJEN E KOMPANISË AUSTRIAKE QË DO TË PËRGATITË PROJEKTIN
E FISIBILITETIT NË LIDHJE ME PROJEKTET NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT, QË DO TË FINANCOHEN NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT
FINANCIAR ME AUSTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të përzgjedhë kompaninë austriake që do të përgatitë projektin e fisibilitetit, si dhe të paguajë koston lokale të vlerës përkatëse të këtij projekti, për identifikimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të qeverisjes elektronike, që do të financohen në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë.

2. Përzgjedhja do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në letërkëmbimin ndërmjet AKSHI-t dhe palës austriake.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.35, datë 5.11.2010

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve të institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Nuk pranohen aplikime nga kandidatët e shpallur fitues me formularët A2 dhe A3, të zgjedhur në listat përfundimtare.

2. Kuotat e pranimeve sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve të institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011” të përdoren në masën:

a) 80% për aplikantët që nuk ndjekin asnjë program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë ose të pjesshme, në IAL-të publike.

b) 20% për aplikantët për program të dytë studimi, të cilët kanë përfunduar një program studimi.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë të organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, ku aplikanti duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopjoja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh në një nga bankat e nivelit të dytë;

e) Deklaratë që vërteton se aplikanti nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

6. Në qoftë se aplikanti fitues nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të saj, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të sigluar në drejtorinë arsimore rajonale/zyrën arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

7. Aplikantët shqiptarë që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit dhe kërkojnë të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës edhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të udhëzimit nr.11, datë 2.4.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për kriteret e ekuivalentimit dhe regjistrimin në maturën shtetërore 2010 të shtetasve shqiptarë që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit”. Sekretaritet mësimore të njëjësive kryesore i dërgojnë dosjet e këtyre aplikantëve në komisionin për ekuivalentimin e dëftesave të shkollave të mesme të fituara jashtë vendit, në MASH.

8. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritet mësimore, përveç dokumenteve të pikës 5, edhe fotokopje të noterizuar të diplomës së lëshuar nga një institucion publik i arsimit të lartë ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të.

9. Aplikantët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi, duhet t’u nënshtrohen edhe kriterëve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, të bëra publike paraprakisht.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.11.2010, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të pranimit të aplikimeve dhe të regjistrimit të aplikantëve fitues, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve

në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë.

11. Aplikimi i kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të dukimit në distancë, të zhvillohet nga data 15.11.2010 deri në datën 19.11.2010, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Institucioneve publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, listat e kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, brenda orës 16:00 të datës 23.11.2010.

13. IAL-të të dërgojnë në APRIAL brenda datës 23.11.2010, në formë elektronike, listat me aplikantët fitues, për të verifikuar nëse kandidatët janë të regjistruar në ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose të pjesshme. APRIAL-i kryen verifikimin dhe ua dërgon IAL-ve listën me kandidatët që ndjekin një program tjetër studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë ose të pjesshme, në IAL-të publike, nëse ka të tillë.

14. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet prej orës 8:00 të datës 25.11.2010 deri në orën 16:00 të datës 27.11.2010, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

15. Regjistrimi i aplikantëve fitues të bëhet vetëm me dëftesën e pjekurisë të shkollës së mesme, origjinale, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 6 e 7 të këtij udhëzimi. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen atyre kundrejt kërkesës.

16. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në APRIAL, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar në datën 30.11.2010.

17. Aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve, për transferim studimesh, kryhet pas shpërndarjes nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve në statutet dhe rregulloret e IAL-ve publike.

18. Aplikimi për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë i kandidatëve nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe i shtetasve të tjerë të huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të listës për shpërndarjen e kuotave të përcaktuara në shkronjën "ç" të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave. Regjistrimi dhe përzgjedhja e aplikantëve fitues në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distance, kryhet nga institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Pas mbylljes së procesit të të gjitha regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare me regjistrimet e kryera brenda datës 2.12.2010, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

20. Këto njoftime të bëhen publike edhe në mediat e shkruara dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Edukimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.38, datë 2.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.35, DATË 5.11.2010 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve të institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”,

UDHËZOJ:

1. Pika 8 e udhëzimit nr.35, datë 5.11.2010 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, ndryshon si më poshtë:

“8. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretariatë mësimore, përveç dokumenteve të pikës 5, edhe fotokopje të noterizuar të diplomës së lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Edukimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.504, datë 8.11.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimit “Master profesional” në:

- a) “Matematikë-fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- b) “Matematikë-informatikë”, me profil minor në “Fizikë”;
- c) “Biologji-kimi”, me profil minor në “Edukim shëndetësor dhe mjedisor”;
- d) “Gjuhë e huaj anglisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
- e) “Gjuhë e huaj frëngjisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
- f) “Gjuhë e huaj italisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;

- g) “Gjuhë e huaj gjermanisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - h) “Histori-gjeografi”, me profil minor në “Edukatë qytetare”;
 - i) “Edukatë qytetare-histori”, me profil minor në “Gjeografi”;
 - j) “Edukatë qytetare-gjeografi”, me profil minor në “Histori”.
2. Programet e studimit “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.
3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master profesional” në:
- a) “Matematikë-Fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
 - b) “Matematikë-Informatikë”, me profil minor në “Fizikë”;
 - c) “Biologji-kimi”, me profil minor në “Edukim shëndetësor dhe mjedisor”;
 - d) “Gjuhë e huaj anglisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - e) “Gjuhë e huaj frëngjisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - f) “Gjuhë e huaj italisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - g) “Gjuhë e huaj gjermanisht”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - h) “Histori-gjeografi”, me profil minor në “Edukatë qytetare”;
 - i) “Edukatë qytetare-histori”, me profil minor në “Gjeografi”;
 - j) “Edukatë qytetare-gjeografi”, me profil minor në “Histori”.
5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.505, datë 8.11.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË
UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, të programeve të studimit “Master profesional” në:
 - a) “Gjuhë dhe qytetërim italian”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - b) “Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek”, me profil minor në “Lëndë shoqërore”.
2. Programet e studimit “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.
3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2010-2011.
4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master profesional” në:
 - a) “Gjuhë dhe qytetërim italian”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - b) “Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek”, me profil minor në “Lëndë shoqërore”.
5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.506, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programeve të studimit “Master profesional” në:

- a) “Matematikë-fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- b) “Informatikë”, me profil minor në “Matematikë”;
- c) “Matematikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- d) “Histori-geografi”, me profil minor në “Edukim qytetar”.

2. Programet e studimit “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master profesional” në:

- a) “Matematikë-fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- b) “Informatikë”, me profil minor në “Matematikë”;
- c) “Matematikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- d) “Histori-geografi”, me profil minor në “Edukim qytetar”.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.507, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË
UNIVERSITETIN “FAN.S.NOLI”, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Mësuesisë të universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, të programeve të studimit “Master profesional” në:

- a) “Gjuhë-letërsi”, me profil minor në “Sporte”;
- b) “Matematikë dhe fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- c) “Matematikë dhe informatikë”, me profil minor në “Fizikë”.

2. Programet e studimit “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master profesional” në:

- a) “Gjuhë-letërsi”, me profil minor në “Sporte”;
- b) “Matematikë dhe fizikë”, me profil minor në “Informatikë”;
- c) “Matematikë dhe informatikë”, me profil minor në “Fizikë”.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.508, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
UNIVERSITETIN “FAN.S.NOLI”, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Mësuesisë të universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, të programit të studimit “Master i shkencave” në “Gjuhë angleze” me profil minor në “Arte”.

2. Programi i studimit “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

3. Programi i studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma “Master i shkencave” në “Gjuhë angleze” me profil minor në “Arte”.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.509, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programit të studimit “Master i shkencave” në “Gjuhë shqipe-letërsi”, me profil minor në “Arte”.

2. Programi i studimit “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

3. Programi i studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma “Master i shkencave” në “Gjuhë shqipe-letërsi”, me profil minor në “Arte”.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.510, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit i Tiranës, të programeve të studimit “Master i Shkencave” në:

- a) Sisteme informacioni në ekonomi;
- b) Kontabilitet dhe auditim;
- c) Financë, me profil:
 - i) Drejtues financiar;
 - ii) Ndërmjetës bankar;
 - iii) Ndërmjetës jobankar;
- d) Ekonomiks;
- e) Administrim publik;
- f) Administrim biznesi, me profil:
 - i) Menaxhim;
 - ii) Menaxhim i burimeve njerëzore;
- g) Kërkimet operacionale;
- h) Marketing;
- i) Menaxhim turizmi.

2. Programet e studimit “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master i shkencave” në:

- a) Sisteme informacioni në ekonomi;
- b) Kontabilitet dhe auditim;
- c) Financë, me profil:
 - i) Drejtues financiar;
 - ii) Ndërmjetës bankar;
 - iii) Ndërmjetës jobankar;
- d) Ekonomiks;
- e) Administrim publik;
- f) Administrim biznesi, me profil:
 - i) Menaxhim;
 - ii) Menaxhim i burimeve njerëzore;
- g) Kërkimet operacionale;
- h) Marketing;
- i) Menaxhim turizmi.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj

10371

URDHËR
Nr.511, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
“EKONOMI DHE AGROBIZNES” NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të programit të studimit “Master i shkencave” në “Ekonomi dhe agrobiznes”.
2. Programi i studimit “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.
3. Programi i studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
4. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma “Master i shkencave” në “Ekonomi dhe agrobiznes”.
5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.512, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të studimit “Master i shkencave” në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në:
 - a) Matematikë-financë;
 - b) Aktuaristikë;
 - c) Fizikë;
 - d) Financë;
 - e) Pasuri të paluajtshme (Real Estate);
 - f) Shkenca kompjuterike.
2. Programet e studimit “Master i shkencave” realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.
3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master i shkencave” në:

- a) Matematikë-financë;
- b) Aktuaristikë;
- c) Fizikë;
- d) Financë;
- e) Pasuri të paluajtshme (Real Estate);
- f) Shkenca kompjuterike.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.554, datë 9.12.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË NË
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programit të studimeve të ciklit të parë në “Pikturë dhe grafikë”.

2. Programi i studimeve “Pikturë dhe grafikë” realizohet me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 vite akademike.

3. Programi i studimeve të fillojnë në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në “Pikturë dhe grafikë”.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.559, datë 10.12.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË
DHE TË DYTË NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të integruar të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, në “Arkitekturë” me profile:

a) Arkitekturë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në arkitekturë, me profil “Arkitekturë”;

b) Urbanistikë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në urbanistikë, me profil “Urbanistikë”.

2. Programi i integruar i studimeve realizohet me jo më pak se 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është jo më pak se 5 vite akademike.

3. Programi i integruar i studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.570, datë 15.12.2010

**PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR TRANSFERIM STUDIMESH,
NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË
DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 33, 35 dhe 36 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në shkronjën “c” të pikës 1, pikat 3, 10, 13 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit për transferim studimesh në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2010-2011, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të

edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, i ndryshuar, mbështetur në kërkesën e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Kuotat e transferimit të studimeve dhënë institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Kuotat e transferimit të studimeve, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shfrytëzohen edhe për transferime nga institucionet private të arsimit të lartë, drejt institucioneve publike të arsimit të lartë, deri në masën 30% të kuotës për transferim të përcaktuar për çdo program studimi.

4. Kuotat e dhëna institucioneve publike të arsimit të lartë për transferime, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shpërndahen, duke respektuar, nga këta të fundit, kriteret e vemdosura në përputhje me aktet nënligjore dhe të publikuara më parë në vende të dukshme prej tyre.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Tabela nr.1

TABELA E KUOTAVE PËR TRANSFERIM STUDIMESH NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME

	Programi i studimit	IAL				
		UE	UBT	UGJ	USH	Shuma
1	Histori				2	2
2	Gjeografi				2	2
3	Histori-gjeografi			3		3
4	Gjuhë-letërsi				2	2
5	Cikli i ulët				3	3
6	Cikli i ulët parashkollor				2	2
7	Matematikë-fizikë	1		3		4
8	Matematikë				2	2
9	Fizikë				2	2
10	Biologji-kimi			3	2	5
11	Drejtësi				20	20
12	Administrim publik			4		4
13	Administrim biznes	10			3	13
14	Financë-kontabilitet	5		4	2	11
15	Turizëm			4	2	6
16	Prodhim bimor		10			10

17	Agromekanizim		10			10
18	Hortikulturë		10			10
19	Mbrojtje bimësh		10			10
20	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi		10			10
21	Zootekni dhe biznes blegtoral		19			19
22	Menaxhim agrobiznesi		10			10
23	Ekonomi dhe politikë agrare		10			10
24	Financë-kontabilitet		10			10
25	Inxhinieri agroushqimore		5			5
26	Vreshtari-enologji		5			5
27	Inxhinieri pyjore		5			5
28	Inxhinieri përpunim druri		5			5
	Gjithsej	16	119	21	44	200

URDHËR

Nr.571, datë 15.12.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE TË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në:
 - a) “Gjuhësi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Gjuhësi”.
 - b) “Letërsi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Letërsi”.
 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.
 3. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2010-2011.
 4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, pa efekte buxhetore shtesë.
 5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.605, datë 29.12.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE TË INXHINIERISË FIZIKE, TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2010-2011, si më poshtë vijon:

- a) Doktoratë në inxhinieri matematike;
- b) Doktoratë në inxhinieri fizike.

2. Programet e studimeve të Doktoratës, në Inxhinieri Matematike dhe në Inxhinieri Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike të UPT-së, zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Në përfundim të programeve të studimeve të Doktoratës, në Inxhinieri Matematike dhe në Inxhinieri Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike të UPT-së, lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të MASH-it dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.606, datë 29.12.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE
SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË “MJEKËSI URGJENCE” DHE “NEUROKIRURGJI”,
NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2010-2011, si më poshtë vijon:

- a) Doktoratë në “Mjekësi urgjence”;
- b) Doktoratë në “Neurokirurgji”.

2. Programet e studimeve specializuese afatgjata në “Mjekësi urgjence” dhe “Neurokirurgji”, në Fakultetin e Mjekësisë të UT-së, realizohen me jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.

3. Në përfundim të programeve të studimeve specializuese afatgjata në “Mjekësi urgjence” dhe “Neurokirurgji”, në Fakultetin e Mjekësisë të UT-së, lëshohet diplomë universitare specializimi me titullin në fushën përkatëse.

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të MASH-it dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.607, datë 29.12.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN EKONOMIK TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2010-2011, si më poshtë vijon:

- a) Doktoratë në kontabilitet;
- b) Doktoratë në menaxhim;
- c) Doktoratë në kërkime operacionale;
- d) Doktoratë në financë;
- e) Doktoratë në sistemet e informacionit në ekonomi;
- f) Doktoratë në statistikë;
- g) Doktoratë në marketing;
- gj) Doktoratë në ekonomiks.

2. Programet e studimeve të Doktoratës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Në përfundim të programeve të studimeve të Doktoratës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të MASH, dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

VENDIM
Nr.30, datë 9.4.2010

**PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “m”, dhe 9 pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 16 të Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 9.4.2010, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në ERE, lidhur me shtesat dhe ndryshimet në rregulloren e procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike, nga burimet e rinovueshme,

VENDOSI:

1. Të shtyjë miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në rregulloren e procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të miratuar me vendimin nr.9, datë 21.2.2007, deri në miratimin e ligjit për energjitë e rinovueshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.52, datë 10.12.2010

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK, PËR SHA
UJËSJELLËS NOVOSELË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjiellës Novoselë”, si më poshtë:

Për ujin e pijshëm	
Konsumator familjar	33 lekë/m ³
Institucione buxhetore	50 lekë/m ³
Ente private	70 lekë/m ³ .

2. Paga rregullatore do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.53, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA
UJËSJELLËS KURBIN

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Kurbin”, si më poshtë:
Për ujin e pijshëm
Konsumator familjar 30 lekë/m³
Institucione buxhetore 80 lekë/m³
Ente private 120 lekë/m³
Tarifë fikse shërbimi 50 lekë/muaj/klient.
2. Pagesa rregullatore do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.
3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.54, datë 17.12.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UJËSJELLËS
PËRMET

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Përmet”, si më poshtë:
Për ujin e pijshëm
Konsumator familjar 38 lekë/m³
Institucione buxhetore 100 lekë/m³
Ente private 120 lekë/m³
Tarifë fikse shërbimi 50 lekë/muaj/klient.
2. Pagesa rregullatore do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.
3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.55, datë 29.12.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA
UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT-KUÇOVË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjiellës Berat-Kuçovë”, si më poshtë:

Spektori Berat	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar	35 lekë/m ³	8 lekë/m ³
Institucione buxhetore	110 lekë/m ³	14 lekë/m ³
Ente private	110 lekë/m ³	16 lekë/m ³ .
Spektori Kuçovë	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar	36 lekë/m ³	8 lekë/m ³
Institucione buxhetore	110 lekë/m ³	14 lekë/m ³
Ente private	110 lekë/m ³	16 lekë/m ³ .

2. Pagesa rregullatore do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2011 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 23.2.2011
Doli nga shtypi më 25.2.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë